L I G J
Nr.8089, datë 21.3.1996

PËR SHOQËRITË KURSIM - KREDI

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizim

Shoqëritë kursim-kredi (SHKK) janë bashkime vullnetare të personave fizikë ose juridikë për kryerjen e veprimeve kursim-kredi, kryesisht për mbledhjen e kursimeve të anëtarëve dhe për dhënien atyre të kredive. Fitimi që krijohet nuk u ndahet anëtarëve të shoqërisë, por shërben për zhvillimin e veprimtarisë së saj.

Neni 2
Ligjet e referimit

Shoqëritë kursim-kredi (SHKK) rregullohen nga dispozitat e këtij ligji dhe bazohen në parimet e ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok. Për shoqëritë kursim-kredi (SHKK) nuk zbatohet ligji për sistemin bankar.

Neni 3
Pavarësia në marrjen e vendimeve

Shoqëritë kursim-kredi (SHKK) janë të lira të ushtrojnë veprimtarinë e tyre e të marrin vendimet përkatëse, brenda kuadrit të akteve ligjore e nënligjore.

Neni 4
Personaliteti juridik

SHKK janë persona juridikë. Ato kanë zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe aftësi për të kryer veprimtari kursim-kredi, duke siguruar burimin e të ardhurave financiare, me kusht që kjo veprimtari të kryhet tërësisht me anëtarët bashkëpunues të shoqërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji. Çdo SHKK ka vulën e saj.

Neni 5
Afati i veprimtarisë

SHKK mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre me një afat maksimal deri në 99 vjet. Shoqëritë mund të caktojnë afatin e veprimtarisë në statutet e tyre. Me mbarimin e afatit maksimal shoqëria mund të vendosë zgjatjen ose përsëritjen e këtij afati.

Neni 6
Territori

SHKK kanë territorin e tyre, shtrirja e të cilit përcaktohet në statutin e shoqërisë.

Neni 7
Selia

SHKK kanë selinë e tyre përkatëse që vendoset brenda territorit të shoqërisë. Selia e shoqërisë mund të transferohet me vendim të asamblesë së shoqërisë.

Neni 8
Emërimi

SHKK kanë emërtimin e tyre që caktohet në statut. Në shkresat, publikimet dhe të gjitha dokumentet e shoqërisë, emërtimi i saj duhet të paraprihet nga fjalët "shoqëri kursim-kredi" pas të cilave shënohet emri i saj dhe numri i regjistrimit të shoqërisë në gjykatë.

KREU II
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 9

Objekti i veprimtarisë së SHKK është depozitimi i kursimeve të anëtarëve të shoqërisë e personave të tjerë dhe shtimi i vlerës financiare të këtij kursimi, dhënia e kredive anëtarëve të shoqërisë dhe përcaktimi i detyrimeve që rrjedhin prej tyre. Qëllimi i veprimtarisë së saj është ndihma reciproke anëtarëve që bëjnë pjesë në të.

Neni 10
Kryerja e veprimtarisë

SHKK mund të kryejnë vetëm veprimtari që përfshihen në objektin e veprimtarisë së përcaktuar në statutin e tyre, si dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm për plotësimin e këtij objekti. SHKK duke qenë persona juridikë, i kanë mundësitë për të rifinancuar kreditë e tyre ose për të vendosur kursimet në çdo bankë. SHKK me veprimet e tyre financiare duhet të mos rrezikojnë interesat financiare të anëtarëve të shoqërisë. Administratorët kanë përgjegjësi disiplinore ose financiare, kur në saje të veprimeve të tyre të gabuara dëmtohen interesat financiare të anëtarëve të shoqërisë. Administratorët kanë përgjegjësi penale, në rast se gjatë ushtrimit të detyrës së tyre kryejnë vepra penale me karakter penal.

Neni 11
Krijimi i bashkimeve

SHKK mund të formojnë bashkime shoqërish. Bashkimet SHKK rregullohen nga ky ligj. Llojet e bashkimeve të shoqërisë dhe emërtimet e tyre përkatëse ose qëllimet dhe objekti i veprimtarisë së tyre përcaktohet në statutet e tyre. SHKK, anëtarë të një bashkimi, mund të realizojnë ndërmjet tyre veprime kontrolli dhe rifinancimi. Rrjeti që do të përfshijë shoqëritë bazë dhe bashkimet e shoqërive në shkallëzim sipas instancave, mund të krijojë një bankë. Krijimi i kësaj banke i nënshtrohet kërkesave të ligjit "Për sistemin bankar". Banka do të ketë për qëllim të rifinancojë shoqëritë që e krijojnë, të administrojë të ardhurat dhe tepricat e krijuara nga burime financiare.

Neni 12
Pjesëmarrja

SHKK mund të jenë anëtarë në bashkimet e shoqërive kursim -kredi a në çdo shoqëri tjetër, ose të krijojnë edhe shoqëri të reja në përputhje me kërkesat e ligjit përkatës.

Neni 13
Veprimet me të tretët

SHKK mund t'i kryejnë veprimet me anëtarët e shoqërisë, ose dhe me persona të tretë, që nuk janë anëtarë të shoqërisë, sipas përcaktimeve të parashikuara në statutet e tyre.

SHKK lejohen të kryejnë veprime me persona të tretë që nuk janë anëtarë të shoqërisë vetëm me kushtet që vijojnë:

- Veprimet me të tretët duhet të përputhen me veprimet që figurojnë në objektin e veprimtarisë së shoqërisë kursim-kredi.
- Veprimet me të tretët mund të realizohen në kushte më të favorshme për të tretët në raport me anëtarët e shoqërisë.
- Veprimet kryhen me të tretë që banojnë në territorin e shoqërisë.
- Xhiroja e secilës veprimtari që përcaktohet në statutin e shoqërisë duhet të realizohet jo më pak se gjysma me anëtarët e shoqërisë dhe vetëm pjesa tjetër me persona të tretë.

Veprimet e realizuara me persona të tretë duhet të kontabilizohen në veçanti.

KREU III
ANËTARËT E SHOQËRISË KURSIM-KREDI

Neni 14
Anëtarët

Anëtarët e SHKK janë persona fizikë ose juridikë, të cilët dëshirojnë të realizojnë bashkërisht veprime ekonomike kursim-kredi në gjirin e shoqërisë dhe që pranojnë statutin e miratuar nga shoqëria kolektive. Anëtari i SHKK mund të bëhet çdo person fizik madhor dhe çdo person juridik, që banon ose vepron në territorin e SHKK.

Neni 15
Numri i anëtarëve

Për t'u themeluar, shoqëria duhet të ketë jo më pak se 7 anëtarë. Numri i anëtarëve të shoqërisë gjatë ekzistencës së saj mund të rritet pa asnjë kufizim. Ky numër mund edhe të pakësohet, por gjithmonë me kusht që të mos mbetet me më pak se 7 anëtarë. Kur shoqërisë i mbeten më pak se 7 anëtarë dhe numri i tyre nuk plotësohet gjatë një viti, shoqëria prishet.

Bashkimet e shoqërive për t'u themeluar duhet të kenë jo më pak se dy anëtarë.

Neni 16
Kushtet e pranimit

Anëtar i SHKK mund të bëhet çdo person fizik ose juridik që plotëson kushtet për pranim të përcaktuara në statutin e shoqërisë. Kërkesa për pranim bëhet me shkrim dhe i paraqitet për shqyrtim këshillit administrativ, i cili është organi kompetent që vendos pranimin ose jo të kërkesës.

Neni 17
Humbja anëtarësisë

Cilësia e anëtarit të SHKK humbet kur anëtari heq dorë a përjashtohet nga shoqëria ose vdes. Çdo anëtar i shoqërisë mund të japë dorëheqjen nga shoqëria kur mbaron angazhimi individual i veprimtarisë së tij, ose në kushtet e përcaktuara në statutin e saj. Përjashtimi nga shoqëria bëhet me vendim të këshillit administrativ. Anëtari i përjashtuar ka të drejtë të ankohet në asamblenë e përgjithshme të zakonshme.

Neni 18
Regjistri i pranimeve

SHKK mban një regjistër i cili përmban datën e pranimit të çdo anëtari, si dhe datën në të cilën ai humbet cilësinë e anëtarit.

KREU IV
TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARËVE TË SHOQËRISË

Neni 19
Të drejtat dhe detyrimet

Anëtarët e SHKK kanë të drejta dhe detyra të barabarta, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të shoqërisë parashikohen në statutin e tij.

Neni 20
Masat disiplinore e materiale

Llojet e masave disiplinore e materiale që merren ndaj anëtarëve të SHKK që shkelin detyrat e parashikuara në statut janë këshillim, vërejtje, detyrim për kthimin e kredisë së marrë, ose për kompensimin e dëmit të shkaktuar, konfiskimin e pjesshëm ose të plotë të pjesëve të kapitalit të tij dhe përjashtim nga SHKK. Çdo anëtar i shoqërisë mund të kundërshtojë masat e marra ndaj tij në asamblenë e përgjithshme të ardhshme të zakonshme të shoqërisë. Asambleja, pasi dëgjon ankesën e anëtarit të shoqërisë dhe debaton rreth saj, vendos në mungesë të tij.

Masat disiplinore jepen për shkeljet e parashikuara në statutin e shoqërisë.

KREU V
ORGANET E SHOQËRISË KURSIM-KREDI

Neni 21
Organet drejtuese

Organet e SHKK janë: asambleja e përgjithshme, këshilli administrativ dhe këshilli mbikëqyrës. Në rastin e një shoqërie me shtrirje territoriale të madhe, statuti mund të parashikojë si organe dhe asamblenë rajonale. Asambleja e përgjithshme zgjedh kryesinë e saj që përbëhet nga një kryetar, dy nënkryetarë e një sekretar, për drejtimin e mbledhjeve dhe marrjen e vendimeve.

Neni 22
Asambleja e përgjithshme

Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqërisë dhe është organi vendimor i shoqërisë. Vendimet e asamblesë janë të detyrueshme për çdo anëtar të shoqërisë.

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme të zakonshme është e vlefshme, kur në të marrin pjesë më shumë se 3/4 e numrit të anëtarëve. Çdo anëtar i shoqërisë mund të përfaqësohet nga një anëtar tjetër që pajiset me një mandat me shkrim. Vendimet e asamblesë së përgjithshme të zakonshme janë të vlefshme kur miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm.

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme është e vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Vendimet e asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme merren jo më pak se 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Në rastin kur numri i anëtarëve të shoqërisë nuk arrihet të mblidhet, thirret një asamble e re e përgjithshme me të njëjtin rend dite, brenda dy muajve nga data e dështimit të asamblesë së mëparshme. Vendimet e asamblesë së re të përgjithshme janë të vlefshme, pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

Asambleja e përgjithshme është e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Asambleja e përgjithshme e zakonshme vjetore thirret një herë në vit nga këshilli administrativ ose nga këshilli mbikëqyrës, ose kur atë e kërkon të paktën 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të shoqërisë. Asambleja e përgjithshme e zakonshme thirret nga këshilli administrativ a nga këshilli mbikëqyrës, ose kur kërkohet nga 1/10 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Neni 23
E drejta e votës

Çdo anëtar i SHKK, në kohën e ushtrimit të veprimtarisë së asamblesë së përgjithshme, ka të drejtën e një vote. Në bashkimet e shoqërive e drejta për numrin e votave që do të ketë çdo anëtar, caktohet në statutin e tyre.

Neni 24
Shpërblimi i funksioneve

Funksionet e anëtarëve të SHKK në organet e ndryshme të saj ushtrohen, si rregull, pa pagesë. Shpenzimet e bëra nga ushtrimi i këtyre funksioneve paguhen. Këshilli administrativ vendos për shumën e këtyre pagimeve.

Neni 25
Asambleja e përgjithshme e zakonshme dhe e zakonshme vjetore

Anëtarët e SHKK mund të mblidhen në çdo kohë në një asamble të përgjithshme të zakonshme për të marrë vendime për çështje të tjera nga ato që janë kompetenca të asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme dhe të asamblesë të përgjithshme vjetore.

Asambleja e përgjithshme e zakonshme vjetore mblidhet brenda 4 muajve pas mbarimit të veprimtarisë së vitit kalendarik. Ajo shqyrton e vendos për raportin e gjendjes financiare të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, për raportin e veprimtarisë së këshillit administrativ, si dhe për të gjitha çështjet e tjera të veprimtarisë ekonomike e të drejtimit, që çmohen të rëndësishme prej saj.

Neni 26
Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme mblidhet në çdo kohë, si në rastet kur paraqitet nevoja që të vendosë për ndryshimin e statutit të shoqërisë, për prishjen e shoqërisë, për transformimin e saj në një formë tjetër, për krijimin e një bashkimi, si dhe për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera.

Neni 27
Asambleja rajonale

Asambleja rajonale që vepron në territorin e rajonit të përcaktuar në statutin e shoqërisë, mblidhet në çdo rajon para asamblesë së përgjithshme, për të debatuar në lidhje me çështjet e rendit të ditës së asamblesë së përgjithshme, por nuk merr vendim për to. Asambletë rajonale caktojnë të deleguarit që përfaqësojnë anëtarët e shoqërisë rajonale në asamblenë e përgjithshme. Numri i të deleguarve të çdo rajoni caktohet nga këshilli administrativ i shoqërisë. Të deleguarit nuk lejohet të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme.

Neni 28
Këshilli administrativ

Këshilli administrativ përbëhet nga jo më pak se tre administratorë që zgjidhen nga asambleja e përgjithshme midis anëtarëve të SHKK, për një periudhë të caktuar në statut dhe që mund të hiqen në çdo kohë prej saj. Këshilli administrativ zgjedh nga gjiri i tij kryetarin dhe zëvendësin e tij. Administratorët zgjidhen për tre vjet. Një e treta e këshillit administrativ rinovohet çdo vit. Çdo administrator që largohet ka të drejtë të rizgjidhet menjëherë.

Për bashkimet e shoqërive rregullat për përbërjen e këshillit administrativ, periudhën e veprimtarisë dhe për shkarkimin e anëtarëve të këshillit administrativ caktohen në statut.

Këshilli administrativ është organi administrativ i SHKK, i cili administron shoqërinë në kuadrin e orientimeve të vendosura nga asambleja e përgjithshme dhe jep llogari para saj. Këshilli

administrativ thirret në mbledhje nga kryetari ose zëvendëskryetari sa herë që është e nevojshme, por jo më pak se një herë në tre muaj.

Këshilli administrativ pranon kërkesat për kursim, fikson përqindjet e interesit, si dhe kushtet e kthimit, administron veprimet e rifinancimit e të rivendosjes, si dhe kryen çdo kompetencë tjetër të caktuar në statut. Këshilli administrativ, në rast se në statut nuk është parashikuar krijimi dhe funksionimi i komitetit të kredisë, jep kredi sipas rregullave të përcaktuara, fikson përqindjet e interesit dhe kushtet e kthimit të kredisë, kërkon kthimin e menjëhershëm dhe pa afat të kredisë, në rastin kur garancia e huamarrësit është e dyshimtë.

Kryetari i këshillit administrativ përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët.

Të drejtat dhe detyrat e këshillit administrativ dhe rregullat e veprimtarisë së tij caktohen në statutin e shoqërisë. Këshilli administrativ mund të caktojë një drejtor për të siguruar administrimin e përditshëm të SHKK. Drejtori shpërblehet vetëm në formën e një rroge që caktohet nga këshilli administrativ dhe jep llogari për të gjitha veprimet e tij para këtij këshilli.

Neni 29
Këshilli mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës është organi i kontrollit të SHKK mbi veprimtarinë administrative dhe financiare të saj. Ai ka si mision të mbikëqyrë çdo veprim të realizuar sipas statutit të SHKK, ligjeve e akteve nënligjore, të vëzhgojë nëse këshilli administrativ merr vendime në përputhje me statutin dhe vendimet e asamblesë së përgjithshme dhe të mbikëqyrë drejtimin financiar të shoqërisë, si dhe të vlerësojë rreziqet operacionale të këshillit administrativ. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë, të cilët zgjidhen prej Asamblesë së Përgjithshme nga radhët e anëtarëve të shoqërisë ose edhe jashtë saj. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk lejohen të jenë në të njëjtën kohë anëtarë të këshillit administrativ. Këshilli mbikëqyrës nuk merr asnjë vendim dhe nuk mund të ushtrojë asnjë sanksion. Çdo vit ai i paraqet asamblesë së zakonshme vjetore një raport për drejtimin e veprimtarisë ekonomike e financiare të shoqërisë. Këshilli mbikëqyrës mund t'i paraqesë një raport të tillë çdo asambleje të përgjithshme, ose mund të thërrasë një asamble të zakonshme ose të jashtëzakonshme për çdo problem të rëndësishëm që çmon se duhet diskutuar.

Neni 30
Komiteti i kredisë

SHKK në statuset e tyre mund të parashikojë krijimin e komitetit të kredisë si një organ i veçantë i shoqërisë. Anëtarët e komitetit të kredisë zgjidhen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë midis anëtarëve të saj. Ata mund të zgjidhen edhe midis anëtarëve të këshillit administrativ, sipas rregullave të caktuara në statut. Komiteti i kredisë detyrohet të shpërndajë kreditë, në përputhje me politikat e procedurat e caktuara. Komiteti i kredisë jep llogari para asamblesë së përgjithshme.

KREU VI
KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 31
Kapitali

Shoqëria SHKK ka kapitalin e saj, i cili përbëhet nga shuma e përgjithshme e vlerës së pjesëve (kontributeve) që derdhin anëtarët e shoqërisë.

Neni 32
Përbërja e kapitalit

Kapitali i një shoqërie është i përbërë nga një numër i papërcaktuar pjesësh. Pjesët e kapitalit të shoqërisë KK janë nominativë dhe kanë secila të njëjtën vlerë që caktohet në statutin e shoqërisë.

Vlera e pjesëve të kapitalit të caktuar në statutin e shoqërisë, në asnjë rast nuk mund të rivlerësohet e të rritet, duke u përfshirë në to rezervat e krijuara ose çdo pasuri a vlerë tjetër e krijuar

nga shoqëria gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 33
Ndryshimi i kapitalit

Kapitali i SHKK mund të ndryshojë në rritje a në zbritje, në bazë të numrit të anëtarëve të shoqërisë dhe të pjesëve të kapitalit që ka çdo anëtar, si dhe sipas vlerës së çdo pjese të kapitalit të shoqërisë. Kapitali i shoqërisë mund të ulet me shtimin e humbjeve të saj.

Neni 34
Kufizimi i uljes së kapitalit

Gjendja neto e kapitalit të SHKK përbëhet nga kapitali i saj dhe nga fondet e rezervave, si dhe nga pasuritë e tjera që rezultojnë pas zbritjes së humbjeve të veprimtarisë së shoqërisë. Gjendja neto e kapitalit të shoqërisë nuk mund të ulet nën 3/4 e gjendjes neto maksimale të kapitalit të konstatuar nga një asamble e përgjithshme.

Neni 35
Nënshkrimi i pjesëve të kapitalit për pranim

Për të qenë anëtar i një SHKK-je, çdo person duhet të nënshkruajë një ose disa pjesë të kapitalit. Pjesët e kapitalit të shoqërisë kanë vlerë të njëjtë. Numri i pjesëve për të qenë anëtar përcaktohet në statutin e çdo shoqërie dhe nuk varet nga veprimtaritë që anëtari i shoqërisë kryen me shoqërinë. Numri i pjesëve të kapitalit duhet të jetë i njëjtë për çdo person që kërkohet të pranohet anëtar i shoqërisë ose për çdo anëtar të pranuar.

Pjesët e kapitalit të nevojshëm për pranimin e çdo anëtari në shoqëri nuk shpërblehen.

Pjesët e tjera të kapitalit që nuk janë të nevojshme për pranimin e anëtarit në shoqëri, shpërblehen dhe janë të kthyeshme.

Për të kryer një veprimtari kursimi nuk është e nevojshme të mbahet një numër i madhe pjesësh të kapitalit nga ai që kërkohet për të qenë anëtar i shoqërisë.

Statuti i shoqërisë mund të parashikojë kushte që për marrjen e kredisë anëtari duhet të nënshkruajë pjesë të tjera kapitali në raport me shumën e kredisë.

Neni 36
Pagimi i pjesëve të kapitalit

Në statutin e SHKK mund të parashikohen kushtet e nënshkrimit dhe të pagimit të pjesëve të kapitalit, për garanci të veprimeve që anëtarët kryejnë me shoqërinë.

Neni 37
Shpërblimi i pjesëve të kapitalit

Asnjë e ardhur nga veprimtaria e shoqërisë nuk u shtohet pjesëve të kapitalit të SHKK. Pjesët e kapitalit të nevojshëm për t'u bërë anëtar nuk shpërblehen. Pjesët e tjera të kapitalit të shoqërisë shpërblehen në formë interesi, përqindja maksimale e të cilit fiksohet sipas mesatares së përqindjeve të konstatuara për huatë afatgjatë në tregun konkurrent financiar. Rregullat dhe kushtet e dhënies së shpërblimit caktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 38
Kontributi në natyrë

Pjesët e kapitalit të SHKK mund të jepen në lekë ose në natyrë. Ato shlyhen plotësisht kur paguhen lekët ose kur kontributi në natyrë vlerësohet nga ekspertët përkatës dhe vihet në dispozicion të shoqërisë. Kur vlera e kontributit në natyrë është më e madhe se detyrimi i anëtarit të shoqërisë, diferenca mund të jetë objekt i dhënies kompensim të pjesëve të kapitalit më afatgjatë.

Neni 39
Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit të shoqërisë trashëgohen. Ato mund të blihen nga persona të tretë ose nga anëtarë të shoqërisë. Në këto raste transferimet e pjesëve të kapitalit duhet të autorizohen paraprakisht nga këshilli administrativ i SHKK.

Neni 40
Kushtet e kthimit të pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit të SHKK, në rast të largimit, u kthehen anëtarëve vetëm me vlerën e tyre nominale, me vendim të mbledhjes vjetore të asamblesë së përgjithshme dhe pasi ajo të ketë konstatuar që të gjitha borxhet e shoqërisë, të cilave u ka arritur afati i skadimit, janë shlyer dhe që pagimi i pjesëve nuk sjell zvogëlimin e gjendjes neto të kapitalit më poshtë se 3/4 e shumës maksimale të konstatuar gjatë një asambleje të përgjithshme.

Neni 41
Regjistri i pjesëve të kapitalit dhe huatë afatgjata

Çdo shoqëri mban një regjistër me emrat e anëtarëve pronarë të pjesëve të kapitalit të shoqërisë, ku shënohen datat e dhënies e të pagesës së pjesëve, si dhe ndërrimit të pronarit të tyre.

SHKK mund të japë pjesë të kapitalit si hua afatgjatë, nënshkrimi i të cilave u regjistrohet anëtarëve të shoqërisë. Regjistrohen edhe pjesët e kapitalit të dhëna hua afatgjatë sipas marrëveshjes së lidhur në kohën e dhënies së tyre.

KREU VII
DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 42
Veprimtaria financiare

Veprimtaria financiare vjetore e SHKK-së fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. SHKK-të për veprimtarinë e tyre mbajnë kontabilitet të rregullt. Kontrolli i tyre bëhet nga shoqëri të specializuara që veprojnë me licencë të lëshuar nga Ministria e Financave. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë informacione e statistika nga SHKK-të.

Neni 43
Analiza e veprimtarisë

Këshilli administrativ i SHKK harton raportin e administrimit, përpilon inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat përkatëse të kontabilitetit dhe ia paraqet për miratim asamblesë së përgjithshme, brenda një afati prej tre muaj duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 44
Fondi i rezervës për mbulimin e rreziqeve

SHKK gjatë çdo veprimtarie detyrohet të mbajë një shumë të hollash që përcaktohet në statut, për krijimin e fondit për mbulimin e rreziqeve të veprimtarisë.

Neni 45
Fondi i rezervës ligjore

SHKK për krijimin e fondit të rezervës ligjore depoziton çdo vit 1/10 (një të dhjetën) e fitimit neto të shoqërisë, derisa fondi i rezervës ligjore të barazohet me vlerën e konstatuar të kapitalit të

shoqërisë.

Neni 46
Fondi i rezervës së detyrueshme

Të ardhurat që realizohen nga veprimtari të tjera të shoqërisë, përveç asaj të kursim-kredisë, si nga shitja e pasurisë ose nga veprime me të tretët, nuk lejohet në asnjë rast t'u ndahet anëtarëve të shoqërisë në çfarëdo forme qoftë. Këto të ardhura detyrimisht futen në një fond, që quhet fondi i rezervës së detyrueshme.

Neni 47
Fondi i rezervës fakultative

SHKK, me vendim të asamblesë së përgjithshme vjetore, mund të krijojë fondin e rezervës fakultative, duke derdhur në të një pjesë nga fitimi neto, i cili përdoret për të përballuar detyrimet ose nevojat e shoqërisë për çdo rast të papritur.

Neni 48
Fondi i rezervës për interesin e pjesëve të kapitalit

SHKK gjatë veprimtarisë së saj mund të krijojë një fond për shpërblimin e interesit vjetor për pjesët e kapitalit që shpërblehen. Përqindja e interesit caktohet çdo vit nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.

Neni 49

Mosprekja e rezervave

Rezervat e SHKK, cilado qoftë natyra e tyre, nuk mund t'u shpërndahen anëtarëve të shoqërisë si në rastin e likuidimit të saj, ashtu dhe në rastin e largimit të tyre nga shoqëria.

Neni 50
Përdorimi i fitimit neto

Asambleja e përgjithshme vjetore, pasi verifikon shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, që u ka arritur afati i skadimit gjatë veprimtarisë së ushtruar, vendos për përdorimin e fitimit neto, i cili deri në shfrytëzimin e tij të plotë, do të përdoret sipas radhës:

1. për krijimin e rezervës ligjore,
2. për krijimin e rezervës së detyrueshme,
3. për krijimin e rezervës fakultative,
4. për caktimin e shpërblimeve për veprimet që anëtarët kanë kryer me shoqërinë.
5. për krijimin e rezervës për rreziqet e veprimtarisë,
6. për krijimin e rezervës për interesin e pjesëve të kapitalit,
7. për caktimin e shumave për të paguar anëtarët e shoqërisë për kursimin e realizuar prej tyre dhe për të ulur kostot e marrjes prej tyre të kredive.

Neni 51
Shpërblimet sipas veprimtarisë në SHKK

Pjesa e fitimit e caktuar për shpërblimet e anëtarëve të shoqërisë mund t'u ndahet atyre vetëm në mënyrë proporcionale me veprimet që ato kanë realizuar në SHKK.

Neni 52
Mbulimi i humbjeve

Në rast se veprimtaria e SHKK del me humbje, ato mbulohen me fondet e krijuara posaçërisht për këtë qëllim. Në rast se këto fonde mbarojnë, atëherë humbjet mbulohen përkatësisht nga rezerva për rreziqet, nga rezerva fakultative, nga rezerva e detyrueshme dhe në fund nga rezerva ligjore. Në rast të mbarimit të rezervave, humbjet mbulohen nga kapitali i shoqërisë. Nëse ky kapital do të ulej për këtë shkak më poshtë se 3/4 e shumës maksimale të konstatuar gjatë një asambleje të përgjithshme vjetore, prishja e shoqërisë do të shpallet nga asambleja e përgjithshme që konstaton këtë ulje, por vetëm nëse anëtarët e shoqërisë nuk do të vendosin të nënshkruajnë pjesë të reja të kapitalit, ose të rritin vlerën nominale të pjesëve, ose të japin brenda një muaji shumat përkatëse për të mbuluar humbjen. Pas këtij afati, nëse nuk veprohet për mbulimin e humbjeve, asambleja e përgjithshme njofton prishjen e shoqërisë.

KREU VIII
REGJISTRIMI E MIRATIMI

Neni 53
Kërkesat për regjistrim

Kërkesa për regjistrim e SHKK duhet të bëhet nga kryetari i këshillit administrativ të shoqërisë dhe depozitohet në gjykatën e rrethit, ku ka selinë shoqëria.

Kërkesa për regjistrimin e shoqërisë duhet të paraqitet së bashku me statutin e saj.

Firmat që figurojnë në kërkesën për regjistrimin e shoqërisë dhe firmat që figurojnë në statutin e saj, duhet të vërtetohen si autentike nga noteri.

Neni 54
Plotësimi i regjistrit

SHKK regjistrohet në një regjistër të veçantë, që mbahet në gjykatën e rrethit ku ka selinë shoqëria.

Deklarohen dhe regjistrohen lloje, kohëzgjatja, nëse kjo është e përcaktuar, emërtimi, selia, objekti i veprimtarisë, vlera e pjesëve të kapitalit dhe emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vendlindjet e anëtarëve të këshillit administrativ.

Depozitohen në aneksin e regjistrit kërkesa dhe statuti i SHKK.

Neni 55
Miratimi

SHKK miratohet nga gjykata e rrethit ku ndodhet selia e shoqërisë. Kërkesa për regjistrim duhet të depozitohet brenda një muaji nga data e themelimit të shoqërisë. Kërkesa për regjistrimin e shoqërisë nuk mund të refuzohet kur statuti i saj është në përputhje me ligjin dhe kur të gjitha dokumentet e kërkuara nga ligji janë të plotësuara.

Gjykata e rrethit detyrohet të njoftojë vendimin e saj brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës. Miratimi konsiderohet si i marrë, në rast se shoqërisë nuk i jepet asnjë lloj njoftimi brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës. Gjykata e rrethit detyrohet t'i njoftojë shoqërisë së miratuar vendimin e miratimit dhe numrin e regjistrimit të saj në regjistrimin e shoqërive të bashkëpunimit reciprok, që mbahet në gjykatë.

Kundër vendimit të gjykatës së rrethit që refuzon miratimin e shoqërisë, lejohet ankim në gjykatën e apelit, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose komunikimit të vendimit.

KREU IX
DISPOZITA E FUNDIT

Neni 56
Përjashtimi nga tatimet

SHKK përjashtohet nga tatimet që lidhen me veprimtarinë e saj kursim-kredi.

Anëtarët e SHKK përjashtohen nga taksat për pjesët e kapitalit që kanë në shoqëri, për të ardhurat nga kursimi dhe për pagesat e interesave mbi kreditë që ata kanë marrë nga shoqëria.

Neni 57
Shpërndarja

Shpërndarja e SHKK mund të bëhet me vendim të një asambleje të përgjithshme të jashtëzakonshme ose mund të shpallet nga një asamble vjetore, e cila konstaton uljen e kapitalit social më poshtë se 3/4 e shumës maksimale të kapitalit të konstatuar në kohën e një asambleje të përgjithshme. Likuidimi kryhet nga një likuidues i caktuar nga asambleja që ka vendosur shpërndarjen. Shpërndarja e SHKK mund të bëhet edhe me mbarimin e afatit të saj, me realizimin e objektit të shoqërisë, me vullnetin e gjithë anëtarëve ose për shkaqe të parashikuara në statutin e saj.

Neni 58
Likuidimi

Likuidimi i SHKK bëhet nga një ose disa likuidues të emëruar nga asambleja e përgjithshme që ka vendosur shpërndarjen e shoqërisë.

Detyrimet dhe përgjegjësitë e likuiduesit rregullohen në bazë të rregullave të miratuara nga asambleja e përgjithshme.

Neni 59
Përdorimi i kapitalit për kthimin e borxheve

Fondet që rezultojnë nga likuidimi përdoren për të paguar detyrimet e shoqërisë. Pjesët sociale të kapitalit të shoqërisë mund të paguhen pjesërisht ose tërësisht, vetëm pasi të jenë paguar të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve.

Neni 60
Përgjegjësia financiare e anëtarëve të shoqërisë

Në rastin kur detyrimet e SHKK nuk mund të shlyhen me pasurinë e saj që rrjedh nga likuidimi, anëtarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e pashlyera të shoqërisë, deri në dyfishin e vlerës nominale të pjesëve të tyre që kanë në kapitalin e shoqërisë të përcaktuar në statut.

Neni 61
Mbetjet pas likuidimit

Pas likuidimit të të gjitha detyrimeve dhe pagesës së pjesëve, në rast se rezulton një mbetje, duhet t'i derdhet detyrimisht në mënyrë humane një vepre me interes të përgjithshëm, social profesional, një shoqërie tjetër kursim-kredi SHKK, ose një bashkim të SHKK-ve.

Neni 62
Shoqatat

Shoqëritë me veprimtari kursim-kredi, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, detyrohen të regjistrohen në gjykatë brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 63

Hyrje në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1443, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha